



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe të nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. **Labinot Salihu**, emërohet në pozitën e këshilltarit të kryetarit të kryeqytetit, nga data 25.09.2018.
- II. Marrëdhënia e punës e të emëruarit si në pikën I të këtij Vendimi pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit.
- III. I emëruari do të realizojë pagën mujore në lartësi prej 484 € (katërqind e tetëdhjetë e katër euro).
- IV. Orari i punës për të emëruarin përcaktohet sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna.
- V. I emëruari për punën e tij do t'i raportojë rregullisht Kryetarit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Të emëruarit;
- Zyrtarit për paga;
- Njesisë së Personelit;
- Qendrës për Shërbime me Qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

